



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2019, ora 17:00

Drejtojnë mbledhjen:

Damian Gjikhuri – bashkëkryetar dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetare

Rend ditës:

Prezantimi i e-election nga kompania Smartmatic

Marrin pjesë:

Damian Gjikhuri, Rudina Hajdari, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj, Adriatik Alimadhi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Klotilda Bushka dhe Adnor Shameti.

Të ftuar:

Andi Erebara – përfaqësues i Smartmatic

Alexander Rakov – përfaqësues i Smartmatic

Guillermo Solis – përfaqësues i Smartmatic

Renold Gonzalez – përfaqësues i Smartmatic

Mohamed Mansour – përfaqësues i Smartmatic

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjikhuri - Hapim mbledhjen e radhës së Komisionit të Reformës.

Siç e vendosëm në mbledhjen e kaluar, do të bëjmë një demonstrim të procesit të votimit elektronik, qoftë *offline*, por edhe *online solution*, për të parë një eksperiencë. Kompania është një nga kompanitë e njohura ndërkombëtare. Kjo do të na vlejë neve për procesin e ardhshëm, nëse do të vendosim të implementojmë një pjesë të teknologjisë, natyrshëm edhe anëtarët e komisionit, por edhe publiku i gjerë do të jenë të interesuar për të parë se si kjo funksionon. Pastaj në pjesën e dytë të mbledhjes do të vazhdojmë me çështjen e mbetur nga hera e kaluar, që është vazhdimi i diskutimit, me pyetjet, nëse ka pyetje të tjera lidhur me prezantimin që bëjnë ekspertët për çështjet e administrimit zgjedhor dhe do të diskutojmë me njëri-tjetrin në lidhje me vazhdimësinë e punës.

Me mirëkuptimin tuaj, le të prezantohen zotërinjtë, të prezantohen se cilët janë si kompani, pastaj të vazhdojmë me demonstrimin për sa i përket votimit elektronik *offline* dhe *online*, që edhe ju keni thënë se është i realizueshëm!

Faleminderit shumë!

Andi Erebara / Përfaqësuesi i kompanisë Smartmatic – Faleminderit për pritjen dhe për mundësinë e demonstrimit të teknologjisë. Kompania quhet Smartmetik, është një ndër kompanitë më të mëdha në botë për organizimin e sistemit të zgjedhjeve, kjo nuk është kompani teknologjike, por është kompani që merret me sistemet zgjedhore dhe profili i saj është vetëm për sistemet zgjedhore dhe asnjë profil tjetër. Përfaqësuesit e kompanisë janë Aleksandër Rakof dhe Muhamed Mosur, të cilët do të na demonstrojnë produktet për votimin elektronik, identifikimin elektronik, si dhe votimin *online* nëpërmjet internetit.

Po ia kaloj fjalën zotit Rakof të bëjë një prezantim të shkurtër të kompanisë dhe pastaj mund të kalojmë te një simulim votimi elektronik direkt me kandidatë të përzgjedhur nga votimet e kaluara.

Aleksandër Rakov - Shumë faleminderit për prezantimin e kompanisë tsonë!

Është kompania më e madhe në botë për sistemet e votimit. Siç e theksova edhe në pjesën e parë, ajo është një kompani që merret me sistemet zgjedhore dhe me sistemet e votimit.

Një ndër projektet e parë është votimi elektronik, i cili do të bëhet në SHBA, në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020 në shtetin e Kalifornisë. Një shtet tjetër, ku do të implementojmë sistemin teknologjik për votimin për kryetar bashkie është Anglia. Shteti

tjetër, i cili ka implementuar teknologjinë është Belgjika, ku votimi elektronik bëhet në shkallë vendi.

Në mënyrë të përmbledhur, me sistemet teknologjike të kompanisë Smartmetik deri tani janë numëruar mbi 6 miliardë vota. Pra, përpos faktit sa mund të tregojë një kompani se sa e madhe është, ka një indikator shumë të thjeshtë, atë të numërimit me teknologjitë e kësaj kompanie, ku deri tani janë numëruar mbi 6 miliardë vota me sistemet e kompanisë “Smartmetik”.

Sot do t’ju demonstrojmë 3 teknologji, që ne menduam se janë me interes për implementimin në sistemin zgjedhor që ka Shqipëria: identifikimi elektronik, votimi elektronik, votimi online nëpërmjet internetit, si dhe siguria, autentifikimi dhe regjistrimi i përdoruesve online, duke demonstruar nivelet e sigurisë që një votim i tillë online kërkon. Dy sistemet e para, ai i identifikimit elektronik dhe votimi elektronik janë sisteme *offline*, nuk janë të lidhura në rrejt, por njëkohësisht menduam që është me interes të demonstrojmë edhe sistemin online. Do të preferonim që të bënit pyetje sapo të keni pyetje të bëni dhe të ishte një seancë komunikimi pyetje-përgjigje, në mënyrë që të jetë më e kuptueshme për të gjitha palët.

Ftoj zotin Masur të fillojë demonstrimin.

Muahmed Mansur – Faleminderit!

Mirëdita të gjithëve!

(Përkthim pa mikrofon)

Bashkim Fino – Zotëria tha: “Merr kartën”, karta e identitetit një sekondë është. Karta e identitetit nuk e tregoi se është Bashkim Fino, atëherë ti do të më tregosh që të vendos gishtat, sepse kam shenjat e gishtave. Një gisht e kam të thyer, një gisht kam të vrarë, pra nuk e di sa gishtërinj të vendos. Pyetja ime ishte: sa zgjat koha për të vënë gishtat? Jo, vetëm për kartën, sepse për kartën e mora vesh që 1 sekondë është. Por nuk del karta në rregull, e vë kartën, por nuk na tregon, çfarë ndodh?

Andi Erebara – Maksimumi mund të shkojë dy sekonda kalimi i kartës dhe një gisht, në qoftë se është i suksesshëm, nëse nuk është, vendoset gishti tjetër e me radhë, pra 1 sekondë njëri, 1 sekondë tjetri.

(Diskutime pa mikrofon)

Pajisja suporton identifikimin një gisht me një gisht, pra atë që votuesi ve dhe lexohet me atë që është ruajtur në pajisje, pra atë që është ngarkuar nga lista e votimit. Por *ai fingerprint* mund të krahasohet edhe me *fingerprint*-in e votuesve të tjerë që janë në atë listë votimi, nëse nevojitet dhe nëse është një veçori e kërkuar, pra pajisja e suporton. Për të

garantuar që, nëse një votues vjen me një ID kartë të ndryshme, detektohet që nuk është ID-ja, karta e tij. Kur i njëjti votues tenton të votojë me po atë ID kartë, pajisja jep një alarm dhe printohet një raport me të dhënat identifikuese dhe me kohën që u tentua një votim i dyfishtë. Çdo raport që printohet nga pajisja, është obsesionale nëse duhet të implementohet dhe printohet, nëse nuk kërkohet, mund të zgjidhet që të mos printohet. Pra, varet nga legjislacioni në fuqi për ato zgjedhje. Këtu mbaron pjesa e identifikimit të votuesit dhe mandej votuesi orientohet të shkojë te makina elektronike e votimit, te pajisja elektronike e votimit.

(Diskutime pa mikrofon)

Pajisja zëvendëson listën e regjistrit të votuesit që ka çdo komision i qendrës së votimit. Kështu që i përgatit njëjta agjenci, Komisioni Qendror të Zgjedhjeve edhe të dhëna e votuesve..

Ralf Gjoni – Kjo është vetëm pjesa identifikimit dhe nuk keni kaluar ende te votimi.

Andi Erebara – Po.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pajisjet konfigurohen me listën e votuesve të asaj qendre votimi. Pajisja suporton si mundësi që të regjistrohen të dhënat e listës së votimit të asaj qendre votimi, por krahasohen të dhënat e një votuesi me atë listë; ekziston edhe mundësia që të dhënat e të gjithë votuesve të instalohen në një pajisje dhe, nëse dikush vjen dhe nuk është votuesi i asaj qendre, anëtari i komisionit e orienton të shkojë ku duhet realisht, nëse ka ngatërruar qendrën e votimit.

Pajisja e identifikimit nuk është e lidhur me pajisjen e votimit. Nuk ka asnjë lidhje midis të dyjave, por, nëse kërkohet, pajisja mund të transmetojë të dhëna për statistika në kohë reale për numrin e pjesëmarrësve, për gjininë e pjesëmarrësve, pra të dhëna që u interesojnë palëve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të ketë *dashboard-in* përkatës që të nxjerrë të dhënat e pjesëmarrësve në kohë reale nga 5500 qendrat e votimit në të gjithë Shqipërinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, është mundur, sepse tregon që je votues i rregullt, por jo kjo qendër, është qendra X apo Y.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk njihesh, prandaj thashë në fillim tregon se je votues i rregullt dhe tregon që nuk ke këtë qendër, por ta orienton adresën diku tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse nuk je fare, nuk je fare votues, është hapi i parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në të gjitha vitet që kompania ka operuar në treg me teknologjinë e tyre janë numëruar mbi 6 miliardë vota deri më tani. Pra, mund të përdoret qoftë e lidhur për të transmetuar të dhënat, por, nëse kërkohet, operohet tërësisht e palidhur me asnjë rrjet, pra *offline*. Pajisja e votimit elektronik është projektuar e tillë që nuk ka asnjë lloj mënyre komunikimi. Nuk ka asnjë portë, asnjë protokoll, ka zero komunikim me rrjetet. Pra, nuk ka asnjë mënyrë komunikimi me të. Duke qenë *offline*, nuk ka mundësi sulmi. Makina mund të operohet vetëm në mënyrë lokale, por çdo portë, çdo pjesë e pajisjes me të cilën lidhet qoftë energjia, qoftë të dhënat në USB, janë të sigurta dhe mund të mbyllet me vulat, njësoj si vulat e kutive të votimit, pra çdo pjesë, që operohet në makinë, është e mbyllshme me vulë. Vulat e sigurisë kanë numër unik. Të dhënat unike të çdo vule, që mbyll pajisjen, fare mirë mund të jenë pjesë e procedurave të procesverbaleve që anëtarët komisionit të KQZ-së mbajnë për vendosjen në fillim dhe në fund gjatë gjithë procedurës. Janë dy fletë për mbrojtjen e privatësisë gjatë procesit të votimit. Sapo të instalohet pajisja në një qendër votimi, duhet që një anëtar ose dy anëtarë, në varësi se si do të jetë procedura e miratuar me ligj, të aktivizojë procesin e fillimit të votimit në pajisje. Pra, instalimi fizik është një gjë dhe bëhet gati, por në orarin e fillimit të votimit anëtarët e komisionit duhet të vënë pasurin dhe të aktivizojnë pajisjen për të votuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është raporti i hapjes së votimit.

Morëm si shembull një me shumë pjesëmarrës, enkas edhe për çështjen nëse ka shumë kandidatë. Imituam zgjedhjet e fundit lokale që u bënë dhe në krye janë kandidatët për kryetarë bashkie, edhe të Tiranës, në rastin konkret, dhe gjithë emrat e partive pjesëmarrëse për bashkinë e Tiranës.

Mund të printohen sa raportet të duhen për hapjen e qendrës së votimit, për partinë, për vëzhgues apo për pjesëmarrës në proces.

Komisioni i qendrës së votimit firmos procesverbalin e hapjes në fillim. Mbasi është printuar dhe është aktivizuar procesi i votimit, hapi i radhës është momenti kur vjen një votues dhe identifikohet, pas procesit të suksesshëm të identifikimit anëtari i komisionit të qendrës së votimit aktivizon sesionin e votimit. Pra, në rastin e votimit elektronik ndërron procedura, nuk i jep një fletë votimi në fund të procesit të identifikimit, por i aktivizon sesionin e votimit. Pra, pajisja tërë kohën është e tillë që nuk mund të votosh pa u aktivizuar me buton dhe ky buton ndodhet larg pajisjes elektronike të votimit, shkon deri në 15 m, sipas përmasave të vendit.

Arsyeja tjetër pse duhet të bëhet aktivizim me buton është se votuesi mund të votojë vetëm një herë, për të bërë një votë të dytë duhet të aktivizohet përsëri nga komisioni, pra është e pamundur të votojë dy herë.

Kemi disa mënyra të aktivizimit të sesionit të votimit. Njëra mënyrë është me buton, pra pas identifikimit korrekt, shtypet butoni nga një anëtar i komisionit dhe votuesit mund t'i hapet fleta e votimit. Aktualisht prezantimi është me një buton, me idenë që për anëtarin e fundit të qendrës së votimit, pro mund të bëhet edhe me dy butona dhe secili nga anëtarët ose dy nga anëtarët mbajnë secili butonin e vet dhe duhet t'i shtypin të dy që të aktivizohet sesioni i votimit.

Mënyra e dytë pa buton është që në momentin që vetë personi identifikohet korrektësisht, i jepet një smartkartë, që e ka komisioni i qendrës së votimit dhe kjo kartë ka vetëm një sesion votimi. Votuesi duhet ta fusë kartën të pajisja e sistemit elektronik që t'i hapet sesioni i votimit, pra fleta e votimit. Në fund të procesit duhet të dorëzojë kartën tek anëtarët e komisionit.

Kjo është një stimulim për të aktivizuar sesionin e votimit. Butoni kthehet në ngjyrë të verdhë për të treguar se është një proces votimi dhe nuk mund të aktivizohet tjetër gjë. Kjo është për t'u treguar anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit.

Personit që po voton i del një ekran konfirmimi, pas çdo përzgjedhjeje për të parë nëse ka shtypur diçka gabimisht.

Për çdo proces përzgjedhjeje votuesit i jepet mundësia në moment të këtë një konfirmim për të parë nëse e ka shtypur gabimisht, pra mund ta konfirmojë ose të kthehet mbrapsht që ta korrigjojë dhe të përzgjedhin dikë tjetër.

Pasi u konfirmua votimi për kryetar, shfaqet fleta e votimit për partitë e këshilltarëve bashkiakë. Votohet për një parti dhe në ekran ka ekzaktësisht të dhënat e fletës së votimit që miraton KQZ-ja, përsëri shfaqet konfirmimi dhe në momenti që votuesi është i bindur mund ta konfirmojë dhe voton për të.

Pasi është konfirmuar, në këtë moment është njësoj sikur vota është hedhur në kutinë e votimit, pra quhet votim i përfunduar.

Pajisja ofron mundësinë që, nëse nevojitet, votuesit mund t'i printohet një kupon konfirmues për votën që hodhi, të cilën e mban votuesi dhe pasi e shikon, e palos dhe e hedh te një kuti votimit normale.

Rëndësia e këtij kuponi konfirmues të votimit dhe qëllimi i përdorimit të kësaj mënyre është që pas përfundimit të procesit të votimit, edhe numërimi manual mund të auditohet dhe të verifikohet, madje një praktikë e mirë është që në të gjitha qendrat e votimit,

ka apo s'ka problematika, 2-3% e qendrave të votimit hapen dhe konfirmohen duke numëruar votat manuale të hedhura në kuti, pra shërben për një proces auditimi më mbrapa, për të konfirmuar sasinë e numërimit manual me votat e hedhura me atë që pajisja elektronike pa nxjerrë si raport përfundimtar.

Procesi i përzgjedhjes së qendrave të votimit që duhet të auditohen dhe të verifikohen mund të jetë i çfarëdoshëm, mund t'i zgjedhin partitë politike, mediet, OJF-të, pra gjithçka bëhet për të krijuar frymën e besimit për rezultatet e gjeneruara nga pajisja elektronike.

Është e njëjta procedurë e sigurisë që, ashtu si votuesit nuk i lejohet të dalë nga qendra e votimit pa hedhur votën, ashtu nuk do i lejohet të dalë nga qendra e votimit pa hedhur kuponin e verifikimit në kutinë e votimit.

Nëse qëllimi i votuesit është shqetësim, nëse e hodhi apo jo, e fshehu s'e fshehu apo gjëra të tilla, ka edhe një version tjetër të votimit elektronik, që makina e hedh vetë automatikisht kuponin e verifikimit të votës në kutinë e votimit.

Në rastin konkret kutia është transparente se është për demonstrim, por normalisht do të jetë jotransparente.

Makina elektronike nuk ka asnjë lloj informacioni për identifikimin e personit dhe këtu ka një barkod me një kod unik që varet nga numri serial unik i makinës, nga dita, ora, minuta, sekonda dhe nga zgjedhjet. Pra, gjenerohet një kod unik që askush nuk mund ta gjenerojë një të tillë me vete, sepse skanohet kodi dhe del që nuk përputhet ose me makinën, ose me qendrën e votimit, ose me votimin, ose me kohën.

(Ndërprerje incizimi)

Ka një mundësi për ta parandaluar këtë gjë, gjithnjë duke marrë të mirëqenë që komisioni i qendrës së votimit bie dakord që ta shkelë, se në fund fare ne biem dakord se ata pranojnë që të bëjnë këtë parregullsi.

Kjo zgjidhet duke përdorur aktivizimin me kartë, pra aktivizimin e sesionit të votimit jo me buton, por me smartkartë, e cila aktivizohet automatikisht nga pajisja e votimit dhe aktivizohet vetëm kur dikush identifikohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë rast, nëse komisioni do ta bëjë qëllimshëm këtë gjë dhe numri i personave të identifikuar është më i ulët se numri i votave në fund fare, pra nëse është ky merak, atëherë kalohet te varianti pa buton, por me smartkartë.

Është edhe opsioni që përmendëm më parë, me dy butona që komandohen nga dy anëtarë të ndryshëm dhe vetëm kur e aktivizojnë të dy, mund të aktivizohet sesioni i votimit.

Kuponi i verifikimit të votës është me letër termike. Arsyeja pse përdoret e tillë është sepse printerët e zakonshëm kanë pajisje që i konsumojnë, si për shembull boja, kurse printeri termik ka vetëm letrën që konsumohet. Kjo gjë ka kosto më të ulët, është më efektive dhe nuk ka pajisje që konsumohen dhe duhen ndërruar. Vetëm shiriti i letrës duhet ndërruar. Kjo mund të printohet me ngjyra apo mund të kostumizohet me logo apo me të dhëna informuese. Mund të shtohen nivele të sigurisë të kuponit të printimit, mund të shtohen fotot e kandidatëve ose logoja e partisë, pra është e menaxhueshme për të shtuar informacionin që kërkohet.

Në një palë zgjedhje të tjera të bëra në një shtet tjetër, një komisioni zgjedhjesh iu tha se kjo më ngjan si letër e një kuponit supermarketi, por diferenca është se kjo e votimit është një letër e veçantë, që nuk dëmtohet kollaj dhe nuk e humbet informacionin.

Të flasim pak për barkodin që ka në mes kuponit të votimit.

Barkodi shërben ndër të tjera edhe për të facilituar procesin e auditimit të verifikimit të votës në kupon.

Procesi i verifikimit pasi procesi i votimit është mbyllur, secila votë mund të verifikohet direkt te qendra e votimit që ka një pajisje elektronike votimi duke skanuar këtë barkod te skaneri i barkoreve, që vetë pajisja e ka, dhe vetë komisioni i qendrës mund të skanojë dhe të identifikojë çdo votë dhe ta numërojë manualisht direkt në QV.

Çdo votë që hidhet te makina elektronike ruhet si e dhënë, si votë, ruhet në mënyrë të rëndomtë, kodohet që askush të mos ketë akses të shikojë se për cilin u votua, por edhe ruhet në mënyrë rëndon, jo sipas radhës së votimit, pra që të mos ndiqet radhe e votimit me atë të identifikimit.

Ralf Gjoni – Çfarë garancie kam unë si votues, se kjo që sapo thatë ju është e vërtetë? Si e kupton që vota nuk ruhet në një sekuencë ndryshe nga ajo që sapo shpjeguat, pra nuk ruhet diku tjetër në një kategori tjetër?

Andi Erebara – Votat ruhen në makinë në disa vende të ndryshme tek i njëjti *hardware* që ka pajisja. Në mënyrë që të garantohet procesi më një pajisje *backup*, makina ka dy memorie USB, që janë të koduara, përveç memories që ka të integruar brenda.

Nëse dikush me qëllim do të dëmtojë makinën, atëherë nuk përbën problem, se mjafton që nga makina e dëmtuar të merren 2 *USB*-të të vihen në një pajisje elektronike tjetër dhe procesi i votimit rifillon po aty ku mbeti.

Ralf Gjoni - Nuk ishte kjo pyetja. Pyetja ishte: çfarë garancie kam unë si votues që vota është realisht e inkriptuar?

(Diskutim në anglisht)

Andi Erebara – Mënyra se si garantohet që pajisja funksionon në mënyrën e kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe që është rënë dakord. Së pari, konfigurimi me parametrat e duhur ashtu siç kërkohet nga një proces zgjedhor, qoftë pajisja, qoftë i gjithë procesi, konfigurimi apo kodi, burimi i vetë makinës, si dhe të gjitha *file-t* që janë brenda makinës auditohen nga një kompani e jashtme eksperte në fushën e auditimit të *software-ve* që ftohet nga KQZ-ja apo nga cili do institucion tjetër përgjegjës për këtë gjë. Auditohet çdo aspekt i funksionimit të makinës edhe kodi, burim i pajisjes. Njëherazi së audituari dhe së provuari që makina bën çfarë është konfiguruar të bëjë dhe e bën siç duhet, së bashku me testimet që bëhen kundër sulmeve, kundër ndërhyrjeve. Kodi dhe të gjitha *file-t* e makinës shënjohen në mënyrë dixhitale, pasi si të thuash bllokohen dhe instalohen në të gjitha makinat e qendrave të votimit. Bllokimi apo shënjimi dixhital është i vlefshëm përgjatë gjithë procesit dhe mund të verifikohet më mbrapa. Pas procesit të votimit, çdo *file*, çdo konfigurim i çdo pajisjeje ka këtë kod dixhital, për të cilin është rënë dakord me kompaninë audituese dhe me KQZ-në. Në çdo moment verifikohet nëse një pajisje ka atë kod, ka kod të ndryshuar apo të modifikuar. Në raste të mëparshme kemi punuar me agjenci të sigurisë kibernetike dhe me parti politike, kontraktojnë një kompani sigurie që auditon procesin në emër të tyre dhe verifikojnë që të dhënat, konfigurimet dhe pajisja janë ato që duhet të jenë.

Në momentin e përfundimit të procesit të votimit, anëtari i komisionit bën procedurën e mbylljes së votimit. Votat që ishin të koduara, të krijuara dekriptohen brenda në makinë, numërohen, printohet raporti i përmbledhjes si shumatore e votave dhe gjenerohet dhe printohet raporti përmbledhës i rezultatit të votimit në pajisjen e votimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, njëlloj si me raportin e hapjes së qendrës së votimit. Raporti është i ngjashëm vetëm se dallon që ka aktualisht numër votash për secilin nga kandidatët dhe partitë që kanë marrë pjesë. Është i njëjti raport, firmoset nga anëtarët e komisionit, printohet në sa kopje duhet për anëtarët e komisionit, për mediet, për OJF-të dhe të interesuarit. Ky është procesverbali i mbylljes së votimit, i cili firmoset.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në momentin që procesi i votimit ka përfunduar dhe rezultatet janë printuar, janë firmosur të dhënat e raportit përfundimtar ruhen te dy pajisjet e memories *USB*, si dhe te memoria e brendshme e makinës. Në këtë moment nëse kërkohet që të transmetohen *online*, mund të transmetohen *online*.

Pajisja nuk ka asnjë teknologji komunikimi, pra nëse kërkohet që të dhënat të transmetohen nga pajisja duhet një *modem GPRS*, modem satelitor, ose një mënyrë tjetër komunikimi, e cila duhet të vihet në dispozicion. Mund të përdoren mënyra të ndryshme komunikimi sipas pajisjes që përzgjedh për të transmetuar të dhënat. Nëse kërkohet mundet që anëtarët e komisionit ta marrin *USB*-në dhe ta çojnë fizikisht pranë *KQZ*-së, nëse kjo është mënyra që kërkohet për transmetimin e të dhënave. Diferenca midis dy makinave është vetëm te ajo që kuponin e votës makina e hedh automatikisht te kutia votimit. Pajisja e parë që ka vetëm printimin e kuponit të verifikimit të votës ka problematikën e qëllimit të votuesit që mund ta marrë kuponin me vete, ta demonstrojë diku për të provuar që votoi për këtë, e cila më pas sjell edhe mospërputhjen e numrit të votave me numrin e kuponëve në kutinë e votimit. Kjo makinë është projektuar me një teknologji që quhet *cut and drop* që e printon dhe e hedh votën automatikisht në kutinë e votimit. Me këtë pajisje përveç konfirmimit në ekranin e pajisjes që do të votohet për kandidatin x, e konfirmon ose jo, votuesi ka edhe konfirmimin në fund me votën e printuar, e cila duket në xhamin e pajisjes para se të pritët dhe të hidhet në kutinë votimit. Votuesi ka përsëri mundësinë që ta konfirmojë, nëse vota është ajo që ai dëshironte apo ta anulojë dhe të votojë edhe një herë nga e para. Një pajisje me funksionalitet të ngjashëm është dhe për këtë makineri votimi, por ajo është më e përmblodhur. E morëm atë për demonstrim, por edhe kjo mund të bashkëlidhet me një kuti votimi të tillë që vota pritët dhe hidhet automatikisht. Në rast se votuesi e anulon votën, do ta ndryshojë atë pasi është printuar, printeri automatikisht i vë një vizë votës dhe ajo hidhet me kryq, me vizë, që është e pavlefshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo nuk është problem, sepse edhe për një ekran të tillë ka pajisje të ngjashme, por për demonstrim u soll ajo.

Patjetër, në fund fare numri i votuesve të identifikuar do të përputhet me numrin e votave. Kjo ishte për arsye auditimi, nëse duhet, nëse është e mundshme, nëse nuk kërkohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në të gjitha vendet që është përdorur teknologjia ka qenë jo pilot, por në të gjithë vendin dhe ka qenë me vlerë ligjore, jo testim. Vota ka qenë ligjore. Në Angli do të përdoret për bashkinë, vitin që vjen. Kemi folur për eksperiencën që do të kenë. E kanë përdorur 7 vjet më parë për çdo votim. Në Belgjikë ka rreth 20 mijë pajisje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Varet nga kërkesat për madhësinë, gjatësinë e printimit. Ruli aktual që kemi këtu është 150 metra i gjatë. Kjo është 10 centimetra. Varet nga kërkesat që ka për printimin. Ka dhe rule më të gjatë që janë më shumë se 150 metra.

Problemi më i madh që haset është se shenjat identifikuese janë të konsumuara nga puna manuale, por që zgjidhet brenda procesit të identifikimit, sepse përdoren gishtat e tjerë që janë gjendje. Është diçka që mund të bëhet me procedurat e votimit, gishti në njëfarë mënyre zëvendëson firmën që ne kemi aktualisht. Nëse si procedurë do të bëhet që të lejohet edhe pa gisht, është e mundur, por varet se si do të vendoset.

(Diskutim në anglisht)

Ajo që *smartmatic* ofron nuk është thjesht teknologjia, pajisjet. Mandej duhet Komisioni Qendror Zgjedhor apo dikush tjetër që ta implementojë vetë. *Smartmatic* fuqinë e vet më të madhe e ka se ofron edhe pjesën e logjistikës në një proces votimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e përkthej që të mos humb procesin e dorëzimit të pajisjeve, të konfigurimit, të trajnimit, pjesën e logjistikës, shpërndarjen. Ndihma teknike në qendrat e votimit, në terren dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për kompaninë është e rëndësishme edhe sukcesi i të gjithë procesit në fund të votimit.

Nga eksperiencia e mëparshme, çka normalisht *Smartmatic* bën, është që sjell një ekip prej pesëmbëdhjetë, njëzet ose më shumë personash, të cilët janë ekipi kryesor i implementimit të teknologjisë. Ky ekip funksionin me partnerë lokalë në terren, që trajnohen dhe suportohen për të bërë gjithë ciklin logjistik të zgjedhjeve; jo vetëm teknologjinë, por edhe pjesën logjistike: shpërndarje, suport, ndërrim, trajnim.

Nga eksperiencia e viteve të mëparshme në lidhje me implementimin e teknologjisë, kemi mësuar se çfarë problematikash mund të kenë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe komisionet lokale të votimit. Këto do të suportohen nga stafi i *Smartmatic*, me qëllim zgjidhjen e problematikave që mund të lindin me votuesit gjatë procesit të votimit, në lidhje me identifikimin, votimin etj.

Për statistikë, meqë pyeti zoti Rusmajli, kemi një rast në Filipine, ku janë pajisur 97 mijë qendra votimi. Shumica problematikave lindin nga sjellja njerëzore, sepse sado që të trajnohen, prapë bëjnë gabime në lidhje me përdorimin e pajisjes. Në Filipine, nga 97 mijë pajisje votimi, 0,3 % ishte statistika e telefonatave, nëpërmjet të cilave anëtarët e komisionit kërkuan suport nga kompania, në lidhje me përdorimin e pajisjeve. Gjatë gjithë procesit, vetëm 0,3 % e qendrave të votimit kërkuan ndihmë. Pak a shumë, shifra është e ngjashme

edhe në implementimet që janë bërë në shtete të tjera, sa i takon votimit me teknologji, votimit elektronik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një procedurë e përdorur më parë, është që komisioni i votimit mban mjetin identifikues të votuesit dhe nuk ia jep mbrapsht pa u siguruar që vota është hedhur në kutinë e votimit; një procedurë jashtë teknologjisë, po themi. Alternativë teknologjike është se ajo pajisje që votuesi nuk e merr votën, bie automatikisht në kutinë e votimit, dhe votuesi s'ka akses në fletën e votimit. Për arsye auditimi, më pas, ky është qëllimi.

Bashkim Fino – Ti vetë e the, që printohet vota, dikush mund ta marrë me vete, dhe votat shkojnë automatikisht në kuti. Po ama votën e kam marrë me vete, se për kë kam votuar. Për këtë të pyeta.

Andi Erebara – Që të jemi të qartë, te ajo kuti nuk e merr gjë me vete votuesi.

Bashkim Fino – Bëhet automatikisht.

Andi Erebara – Te ajo nuk merr gjë me vete votuesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te kjo këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por detyrohet nga komisioni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, se votën e hodhi, por votuesi detyrohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, sistemi ofron si mundësi nëse duhet, nëse bini dakord që t bëni këtë gjë. nëse është ky merak, atëherë ofrohet mundësia e pajisjes tjetër. Edhe kjo e ofron atë teknologji. Për demonstrim, e kemi një të tillë, që votuesi s'e ka fare këtë letër, por hidhet direkt atje.

Ajo që ne po themi, nuk është që kjo duhet të bëhet kështu. Ne po flasim në lidhje me atë çfarë sistemi mundëson. Mandej, jeni ju që do të vendosni se si doni ta bëni. Mundësitë janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull. Ekziston mundësia që edhe të mos printohet fare, ose nëse printohet, të hidhet aty. Varet si do të vendoset.

Bashkim Fino – E kuptova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Andi Erebara – Jo, jo, bëhet në atë moment, pa u larguar nga makina, nga pajisja e votimit. Bëhet në atë moment.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, e bën votuesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, te ajo pajisje ka dy konfirmime: konfirmimin e parë e ke në ekran. Kur bën një përzgjedhje, të del: a je i sigurt se është kjo përzgjedhje? I thua ok. Në atë çast ajo printohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në çastin kur e anulon, printeri i vë vizë votës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë rast, nëse votuesi e anulon dhe dëshiron të votojë ndryshe, dhe ajo është printuar, por nuk është hedhur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, s'është e lidhur fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo s'mund të lidhet. Pa u mbyllur procesi, nuk komunikon fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, absolutisht jo. S'ka fare. Është offline. Që të përvojë, nuk ka fare nevojë për internet.

Myslim Murrizi – Po për punën e dritave, si i bëhet, se s'kemi drita ne?

Andi Erebara – Ka baterinë e vet të integrua, e cila mban deri në dy orë, por pajisja mund të jetë edhe me bateri të jashtme, si ajo e makinave, që mban deri në 12 orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka lindur si nevojë edhe në vende të tjera, kështu që e kanë zgjidhur këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – A ta rrëzoj këtë sistem me vetëm një fjali?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit, prit! Komisioni i qendrës së votimit mund të jetë i korruptuar, mund të kenë marrë pesëmbëdhjetë, njëzet karta identiteti të njerëzve që i i kanë jashtë shtetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Andi Erebara – Mund ta kontrollosh nëpërmjet shenjës së gishtave.

Bashkim Fino – Po ti e ke me kartë. A e ke me kartë?

Po, por këtë problematikë e zgjidh me shenjën e gishtave. E bën si procedurë dhe thua se pa shenjë gishtash nuk votohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tashti, po ia mori edhe gishtin, hallall pastaj! Ja u zgjidh, nuk e hodhe dot. Më thuaj një gjë tjetër.

Damian Gjikhuri – T'i lejojmë zotërinjtë të... Unë e di se kemi edhe atë pjesën online, por nuk ia vlen tani. Për mendimin tim e lëmë një herë tjetër.

Andi Erebara – Në rregull!

Damian Gjikhuri – Sepse, e para, kjo do një lloj shpjegimi më të detajuar, gjë që do ta bëjmë më vonë, kur të vijë momenti, nëse ne do të vazhdojmë të ecim në këtë drejtim. E dyta, do të na nxjerrësh edhe një lloj buxhetimi, me përafërsi.

Andi Erebara – Pjesën online e kishim të parashikuar, vlente për pjesën e votimit të emigrantëve.

Damian Gjikhuri – Po mirë, kur të vijmë te çështja e emigrantëve mund të bëjmë një tjetër, sepse ju këtu jeni dhe kemi mundësi të kontaktojmë prapë.

Andi Erebara – A mund të tregojmë thjesht procedurën e identifikimit online?

Damian Gjikhuri – Jo, jo, lëre, s'kemi kohë, sepse ikin këta dhe më prishen gjëra më të mëdha, më ngel e gjithë reforma.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Andi Erebara – Vetëm dy minuta për pjesën e identifikimit, në lidhje me sistemin e votimit online.

Këtë teknologji përdoret në Estoni. Në Estoni ka që në 2010-ën që përdoret votimi online, dhe kompania implementuese është *Smartmati*.

Ralf Gjoni – E njëjta kompani.

Andi Erebara – E njëjta kompani. Sistemi quhet ndryshe, quhet TIVI, por është e njëjta teknologji.

Estonia është i vetmi vend ku sistemi implementohet në shkallë kombëtare. Është implementuar në Norvegji, në Kili. Sa i takon procesit për identifikimin e votuesit, kur ai është në distancë, përdoret një aplikacion në telefon, të cilin votuesi e ka instaluar te smartfoni i tij. Bëhet një foto e dokumentit të identifikimit, pasaportës ose i kartës ID, dhe sistemi merr të dhënat identifikuese të të gjitha niveleve të sigurisë që ka fotografimi i dokumentit. Këto të dhëna i përdor për të verifikuar që personi që po voton është ai që ka telefonin në dorë. Aplikacioni instalohet para procesit të votimit. Ka një fushatë

sensibilizuese, dhe votuesve u thuhet: shkarkoni aplikacionin, që të mund të votoni online. Kjo bëhet tre muaj para, gjashtë muaj para, ashtu si mund të vendoset.

Pas instalimit të aplikacionit, votuesi mund të hapë faqen që e mban Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, për t'u regjistruar e për të votuar. Pra, i lihet në dorë nëse dëshiron të regjistrohet apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Pasi të flas edhe me kryetarin, do të bëj një njoftim për mbledhje ditën e enjte. Nuk e di si e kemi të enjten. Seancë parlamentare nuk kemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta shikojmë, se mund t'i bëjmë mbledhjet pasdite. Si thua, Bashkim, nga ora pesë? Sepse, nesër kemi tryezën për financimin e partive, ku normalisht do të jetë pjesa më e madhe juaja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nesër në orën 9.

E dyta, të enjten duhet të vazhdojmë me pjesën e administrimit, që ta përfundojmë, me disa vërejtje e sugjerime tona për t'i riparë, për t'i ripunuar. Kuptohet, ju si ekspertë do të punoni vetë, do të bëjmë edhe ndonjë takim më të ngushtë, por e rëndësishme është të dalin disa problematika, të cilat i kam hasur edhe unë.

E treta që kërkoj, është të filloni të punoni, gjë që besoj se edhe të tjerët do të jenë dakord. Nisur nga reforma në drejtësi, çështja skemës së kolegjit bie. Nuk ka më kolegji zgjedhor, sepse aty s'ka më KLD për t'i caktuar. Duhet të mendoni edhe për një skemë, se si do të përzgjidhet Kolegji Zgjedhor.

Pra, duhet të vini edhe me një opsion, bashkë me pjesën tjetër procedurale në lidhje me ankimin e këto. Sepse, kolegji bie, s'ka më KLD, s'ka më variante të tipit jo presidenti etj, kështu që del si gjë shumë e domosdoshme edhe rishikimi i pjesë së ankimit gjyqësor.

Dakord, Alket? Sepse është ky problem. Duhet parë edhe se si do të zgjidhen anëtarët e kolegjit, sepse tashti bie krejt skema, është e bazuar te legjislacioni i vjetër.

Kështu që, duhet të punoni një çikë me atë, Ilir, që javës tjetër të vijmë me disa opsione. Qëllimi është që brenda nëntorit ta kemi gati gjithë skeletin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, do të nxitojmë.

Materialin do ta kemi gati. Ka edhe kohë për negociata.

Dakord?

Mirë atëherë. Në lidhje me ditën e enjte, do të caktojmë orarin ë bashku me Rudinën,
dhe do t'ju njoftojmë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA